



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, me 27 maj 2024, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Fidan Jilta, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, dhe Mergim Lushtaku.

Munguan: Isak Shabani, Adelina Grainca, Agim Veliu dhe Besnik Tahiri.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: e Zyrës së BE-së, OSCE, AGK, Flutura Kusari-juriste, RTK, Kallxo.com, Ekonomia online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina.

Valon Ramadani, njoftoi komisionin se mbledhja është vazhdim i mbledhjes së mbajtur me 26 prill 2024, për shqyrtimin e P/ligjit për KPM-në, nga neni 17.

Komision shqyrtoi raportin e ekspertës znj. Kevin bashkë me propozimet e tjera të grupeve të interesit.

Gjatë shqyrtimit të neneve në vijim, deputeti,

Mergim Lushtaku, kërkoi që neni i P/ligjit që ka të bëjë me të drejtën e partive politike në themelimin e televizioneve të shqyrtoht veçantë.

Besim Muzaqi, nuk u pajtua me propozimin e parafolësit me arsyetimin se çështja në fjalë është e rregulluar me Ligjin për Zgjedhjet, sipas së cilit ligj partive politike nuk ju lejohet hapja e mediumit.

Konstatim: Komisioni shqyrtoi të gjitha propozimet dhe komentet e adresuara në komision dhe hartoi propozim ndryshimet deri tek neni 26 si në vijim:

Amendamenti 1

Titulli i nenit 17, ndryshohet si në vijim:

“Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së”

Amendamenti 2

Neni 17, paragrafi 3, fjalët “Shkarkimi i anëtarëve”, zëvendësohen me fjalët “Shkarkimi i anëtarit”, vazhdon teksti.

Amendamenti 3

Neni 17, paragrafi 3, pika 3.6, fshihet në tërësi.

Amendamenti 4

Neni 17, paragrafi 3, pika 3.8, numri “14”, zëvendësohet me numrin “(15)”.

Amendamenti 5

Neni 18, paragrafi 1, fshihen fjalët “Në mbledhjen e parë” vazhdon teksti.

Amendamenti 6

Neni 25 i projektligjit fshihet në tërësi, ndërsa nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 7

Neni 26, paragrafi 3, fshihet fjala “e transmetimit”.

Amendamenti 8

Neni 26, para nënparagrafit 3.1, shtohet pike e re me tekstin si në vijim:

3.1. “partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individ i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike”, ndërsa nënparagrafi në vazhdim rinumërohet.

Amendamenti 9

Neni 26, paragrafi 4, të fshihet fjala “të transmetimit”.

Amendamenti 10

Neni 26, paragrafi 6, ndryshohet si vijon:” Zyra Ekzekutive mban një regjistër të lejeve dhe regjistrimeve, ku përfshihen kushtet e pajisjes me leje dhe historiku i tyre. Regjistri i lejeve dhe regjistrimeve dhe historiku i tyre publikohet në webfaqen zyrtare dhe përditësohet brenda pesë (5) ditëve pune nga marrja e vendimit të KPM-së.”

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, me 28 maj 2024, në orën: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Fidan Jilta, Isak Shabani, Adelina Grainca, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Agim Veliu dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Mergim Lushtaku.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: e Këshillit të Evropës, e Zyrës së BE-së, OSCE, KPM, Kallxo.com.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina.

Valon Ramadani, njoftoi komisionin se mbledhja është vazhdim i mbledhjes së mbajtur me 27 maj 2024, për shqyrtimin e P/ligjit për KPM-në, nga neni 26.

Gjithashtu, njoftoi komisionin se komisioni do t’i shqyrton propozimet e KPM-së lidhur me dy çështje:

Dezinformimin dhe transparencën.

Fjalën ia kaloi, Kryetarit të KPM-së për t’i prezantuar propozimet,

Jeton Mehmeti, njoftoi komisionin se lidhur me çështjet në fjalë ka hartuar propozimet sipas opinionit ligjor të KiE, i cili opinion është hartuar konform rezolutës së Parlamentit Evropian.

Komisioni shqyrtoi propozimet e KPM-së duke i krahasuar dhe adoptuar me propozimet e tjera.

Gjatë shqyrtimit të P/ligjit komisioni paralelisht shqyrtoi të gjitha propozimet, vërejtjet e akterëve të tjerë dhe hartoi propozim ndryshime për p/ligjin si në vijim,

Amendamenti 1

Në titullin e nenit 27, fshihet fjala “**të transmetimit**”.

Amendamenti 2

Neni 27, paragrafi 1, fjala “lejava”, zëvendësohet me fjalën “lejeve”.

Amendamenti 3

Neni 35, paragrafi 1, riformulohet si vijon: “**Procesi i vlerësimit të aplikacioneve për leje të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale, operatorve të shpërndarjes dhe platformave të shpërndarjes së videove dhe ripërtirja e lejeve duhet të jetë i drejtë dhe transparent.**”

Amendamenti 4

Neni 35, paragrafi 2, riformulohet si vijon: “**Vendimet e KPM-së mbi refuzimin ose mosripërtirjen e lejes arsyetohen me shkrim dhe u dorëzohen aplikantëve nëpërmjet Zyrës Ekzekutive.**”

Amendamenti 5

Neni 35, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri pas pikës **35.3** si në vijim:
35.3 “**KPM-ja nxjerr vendim brenda tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të datës për aplikim ose pranimit të kërkesës për leje.**”, ndërsa paragrafët në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 6

Neni 36 i projektligjit ndryshohet si në vijim:

Teksti i nenit 36, bëhet **paragrafi 1**, me ndryshimet si në vijim: pas fjalës “nga ana”, fshihen fjalët “e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat” zëvendësohet me fjalët “e të licencuarve” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 7

Neni 36, pas paragrafit 1, shtohet paragraf i ri **2**, me tekstin si në vijim:
36.2. “**KPM ruan të drejtën të mos ripërtërijë lejen nëse për këtë ekzistojnë arsye specifike teknologjike dhe rregullatorë.**”

Amendamenti 8

Neni 38, paragrafi 1, fshihen fjalët “Ofruesit e licencuar të shërbimeve mediale audiovizuale” dhe zëvendësohen me fjalët “**Të licencuarit**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 9

Neni 38, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri 5, me tekstin si në vijim:

38.5. “Subjektet që rregullohen nga KPM, janë të obliguara që të ofrojnë brenda afatit të përcaktuar kohor të dhënat e kërkuara nga KPM në baza periodike apo me kërkesë për qëllime të analizës së tregut apo rregullimit në përgjithësi.”

Amendamenti 10

Neni 39.5 riformulohet si vijon: ” Të licencuarit nga KPM kanë të drejtë ankese në gjykatën kompetente, lidhur me lejen, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.”

Amendamenti 11

Titulli i KAPITULLIT V, riformulohet si vijon:

PARIMET DHE DISPOZITAT THEMELORE PËR TË LICENCUARIT

Amendamenti 12

Neni 41, paragrafi 1, fjalët “audio dhe r espe audiovizuale”, zëvendësohen me fjalët “audio dhe audiovizuale”.

Amendamenti 13

Neni 41, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri 5 me tekstin si në vijim:

41.5.” KPM harton rregullore për ndalimin e dezinformimit. Rregullorja përfshin standardet e Bashkimit Evropian dhe normat ndërkombëtare kundër dezinformimit. “

Amendamenti 14

Neni 42, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, me tekstin si në vijim:

42.2” Të gjitha kanalet televizive me përmbajtje gjeneralistike, si dhe ato lokale që kanë leje të përdorimit të frekuencës, i nënrenditen rregullit të bartjes së detyrueshme (must carry) nga ana e operatorëve kabllor dhe atyre dixhital të shpërndarjes. Në rast të tejngarkesës me të tilla kanale, KPM ruan të drejtën të vendos rregulla komerciale të qasjes.”

Amendamenti 15

Neni 42, paragrafi 2 i projektligjit, fshihet në tërësi.

Amendamenti 16

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 43** me tekstin si në vijim:

Neni 43

Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve

1. Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë dhe/ose aksioneve të njoftojë më shkrim KPM-në.
2. Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë mbi vlerën 10% të aksioneve të merr aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja.
3. Asnjë i licencuar/regjistruar nuk mund të transmetojë më shumë se 30% të vlerës së tregut të përgjithshëm medial të komunikimeve komerciale audiovizuale.
4. Një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotërojë me shumë së 10% të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër.
5. Pronësia në media është e lejuar vetëm për kompanitë ose organizatat të cilat janë të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Në shërbim të pluralizmit medial dhe për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, pronarët përfitues duhet të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për preardhjen e pasurisë me rastin e rigjistrimit dhe raportimit financiar vjetor.
7. KPM bazuar në rezultatet dhe nevojat të cilat rezultojnë nga analiza e tregut medial, me akt nënligjor përcakton rregulla specifike për pronësinë, koncentrimin, pluralizmin, diversitetin, dhe transparencën e mediave.

Amendamenti 17

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 44** me tekstin si në vijim:

Neni 44

Analiza e tregut medial

1. KPM bënë analizën e tregut medial në baza vjetore. Analiza e tregut nga KPM bëhet me qëllim të garantimit të konkurrencës së efektshme në fushën e transmetimeve dhe parandalimit të shpërdorimit të fuqisë në treg nga të licencuarit/regjistruarit e KPM-së.
2. KPM përmes një akti të veçantë nënligjor do t'i përcaktojë rregullat dhe standardet përmes të cilave siguron realizimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të analizës së tregut medial.

Amendamenti 18

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 45** me tekstin si në vijim:

Neni 45

Kërkesat lidhur me transparencën e të licencuarve

1. Të licencuarit janë të obliguar t'i bëjnë publike të dhënat në lidhje me emrin dhe detajet e kontaktit të pronarit apo pronarëve të drejtpërdrejtë me aksionet që u mundësojnë atyre të ushtrojnë ndikim në funksionimin dhe vendimmarrjen strategjike të medias, si dhe pronarët përfitues, pronarët indirekt, aksionet indirekte dhe proporcionet e të drejtave të votimit, si dhe;
 - 1.1. Adresa e banimit ose zyrës së regjistruar;
 - 1.2. Emrat e personave me përgjegjësi ekzekutive;
 - 1.3. Emrat e personave të autorizuar që përfaqësojnë kompaninë/organizatën;
 - 1.4. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, nëse ka të tillë;

Amendamenti 19

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 46** me tekstin si në vijim:

Neni 46

Pronësia e huaj

2. Pronësia e huaj lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Rregullat mbi koncentrimin e të licencuarve të KPM-së vlejné edhe për personat fizik ose juridik të huaj.

Nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 20

Neni 47, pas **paragrafit 6** të projektligjit, shtohet **paragraf i ri 7** me tekstin si në vijim:

7. “OSHMA-të dhe OSH-të obligohen të ndërmarrin masat teknike sipas udhëzimeve të KPM-së në rastin e përmbajtjeve me pritshmëri për të dëmtuar zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve.”

Amendamenti 21

Neni 47, pas **paragrafit 6** të projektligjit, shtohet **paragraf i ri 8** me tekstin si në vijim:

8.” Programet e formatit shfaqje reale televizive (reality show ose reality tv) njoftimet e transmetimit të tyre, si dhe programet që tregojnë pasqyra të ngjarjeve në ato përmbajtje, shënohen me 18+ dhe mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 24:00 deri në 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjen e shfaqur me mbrojtje teknike (kodim me pin).”

Amendamenti 22

Neni 47, pas **paragrafit 6** të projektligjit, shtohet **paragraf i ri 9** me tekstin si në vijim:

9. “Programet e formatit (pseudorealiteti), mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 22:00 deri në ora 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjet e shfaqura me mbrojtje teknike (kodim me pin).”

Ndërsa paragrafi 7 i projektligjit rinumërohet.

Amendamenti 23

Neni 56, **paragrafi 1.2**, para numrit “(20.000)” shtohen fjalët” njëzet mijë”.

Amendamenti 24

Neni 56, **paragrafi 1.2**, **pika 7**, para numrit “15” shtohet fjala “pesëmbëdhjetë”.

Amendamenti 25

Neni 56, **paragrafi 1.2**, **pika 23**, fshihen fjalët “nenit 37 të”.

Amendamenti 26

Neni 57, paragrafi 1.4, pas fjalës “tre”, shtohet numri “3”.

Amendamenti 27

Neni 57, paragrafi 2, fjala “zbatohet menjëherë” zëvendësohet me fjalët “është përfundimtar në procedurë administrative.”

Konstatim: Komisioni caktoi mbledhjen e radhës me dt. 30 maj 2024, me rendin e ditës:

Votimi i amendamenteve dhe raportit me rekomandime për komisionet kryesore.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, me 30 maj 2024, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-506

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Fidan Jilta, Isak Shabani, Adelina Grainca, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi dhe Agim Veliu.

Mungoi: Mergim Lushtaku dhe Besnik Tahiri..

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: e Këshillit të Evropës, OSCE, NDI, KDI, IKD/BPD, RTK, KOHA, Kallxo.com, Ekonomia Online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina.

Valon Ramadani, njoftoi komisionin se raporti me rekomandime është përfundimtar dhe propozoi votimin e tyre si në vijim:

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në pajtim me nenin 76 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjet e mbajtura me 07.02, 26.04 dhe 27, 28, dhe 30.05.2024, shqyrtoi dhe amendamenti Projektligjin nr. 08/L-289 për KPM-në dhe vendosi që komisioneve kryesore t`ua paraqes raportin me amendamente si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 2, fjalët “në përputhshmëri të plotë”, zëvendësohen me fjalët “pjesërisht në përputhje” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 2

Neni 2, pas fjalës “shërbime” shtohen fjalët “**audio dhe**”, dhe pas fjalës “**të licencuara**” shtohen fjalët “**dhe të regjistruara**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 3

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1 pika 1, në fund të tekstit të këtij nënparagrafi shtohen fjalët: “, dhe komunikimet komerciale audiovizuale siç përkufizohet në paragrafin 1.24 të këtij neni”.

Amendamenti 4

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1 pika 2, fshihet në tërësi.

Amendamenti 5

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1 pika 3, në fund të tekstit të këtij nënparagrafi shtohet fjala “, përfshirë:”

Amendamenti 6

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1 pika 3.1, referenca për nënparagrafin “1.2”, zëvendësohet me referencën “1.1.3” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 7

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1 pika 3.2, pas fjalëve “shpërndarjen e videove” shtohen fjalët “ose në mediat sociale” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 8

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.10. me tekstin si në vijim:

1.10. “**Leje** – dokument i lëshuar nga KPM për personat fizik dhe juridik për të drejtën e ushtrimit të aktiviteteve në fushën e ofrimit dhe shpërndarjes të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale;”

Amendamenti 9

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.11. me tekstin si në vijim:

1.11. “**Regjistrim** – regjistrim në regjistrin e KPM-së për shërbimet mediale audio dhe audiovizuale online;”.

Amendamenti 10

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.12. me tekstin si në vijim:

1.12. “**Ritransmetimi** - nënkupton ritransmetimin e njëkohshëm, të pandryshuar dhe të pashkurtuar nga një sistem kabllor ose mikrovalor për pranim nga publiku i një transmetimi fillestar nga një shtet tjetër, me tel ose me ajër, duke përfshirë atë me satelit, të programeve televizive ose radiofonike të destinuara për pranim nga publiku;”.

Amendamenti 11

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.13. me tekstin si në vijim:

1.13. “**Pluralizmi mediatik** - përcakton gjendjen e të pasurit një pluralizëm zërash, opinionesh dhe analizash mbi sistemin mediatik ose bashkëjetesa e llojeve të ndryshme dhe të larmishme të mediave;”.

Amendamenti 12

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.14. me tekstin si në vijim:

1.14. “**Pronësia** - Zotërimi i më shumë se 10% të pjesës së kapitalit bazë në një shërbyes medial audiovizuel dhe/ose të pajisjeve të tij;”.

Amendamenti 13

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.15. me tekstin si në vijim:

1.15. “**Pronësia direkte** – pronar të cilët posedojnë aksione në një të licencuar që u mundësojnë atyre të ushtrojnë ndikim në funksionimin dhe vendimmarrjen strategjike të medias;”.

Amendamenti 14

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.16. me tekstin si në vijim:

1.16. “**Pronësia indirekte** - personat fizik me aksione përfituese të cilët zotërojnë ose kontrollojnë aksionet në një media ose në emër të cilëve këto aksioneve mbahen, duke u mundësuar atyre që në mënyrë indirekte të ushtrojnë kontroll ose ndikim në operim dhe vendimmarrje strategjike të medias;”.

Amendamenti 15

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.17. me tekstin si në vijim:

1.17.” **Pronari përfitues** - nënkupton personin fizik i cili i fundit ka në pronësi ose kontrollon subjektin e detyruar dhe/ose personin fizik në emër të të cilit kryhet një transaksion ose veprimtari, ose personi i cili ushtron kontroll efektiv i fundit ndaj një personi juridik ose marrëveshje ose një organizatë jo-qeveritare;”.

Amendamenti 16

Neni 3, pas paragrafit 1. 9, shtohet paragraf i ri 1.18. me tekstin si në vijim:

1.18.” **Koncentrimi i pronësisë së mediave** - nënkupton një situatë ku një numër i vogël individësh ose personash juridik, ose kompanish kontrollojnë aksionet në disa të licencur/regjistruar të KPM-së dhe kanë kontroll (efektiv), gjë që mund të çojë në një ndikim negativ në nivelin e pluralitetit të zërave dhe opinionëve në dispozicion, dhe për këtë arsye pluralizmi dhe diversiteti mediatik nuk sigurohet;”.

Ndërsa paragrafët në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 17

Neni 3, pas paragrafit 1. 11, shtohen nënparagrafët 1.11 pika 1 dhe 1.11.2 me tekstin si në vijim:

1.11.1 Transmetimi televiziv” (d.m.th transmetimi linear i shërbimit medial audiovizuel) është një shërbim medial audiovizuel, i siguruar nga një ofrues i shërbimit medial audiovizual për shikimin e njëkohshëm të programeve, mbi bazën e një skeme programesh;

1.11.2 Shërbimi medial audiovizuel, sipas kërkesës” (d.m.th shërbimi jolinear medial audiovizual) është shërbimi medial audiovizual i ofruar nga ofruesi i shërbimit medial për shikimin e programeve në momentin e zgjedhur nga përdoruesi, në bazë të kërkesës së tij, mbështetur në një katalog programi të përzgjedhur nga ofruesi i shërbimit medial.

Amendamenti 18

Neni 3, paragrafi 1.17, ndryshohet si në vijim:

1.17. “**Plani i frekuencave të transmetimit** - plani i frekuencave për transmetime radio dhe televizione i miratuar nga KPM në pajtueshmëri me brezin e ndarë për Transmetime Radiodifuzive;”.

Amendamenti 19

Neni 3, paragrafi 1.18, ndryshohet si në vijim:

1.18. "**Spektri i frekuencave të transmetimit** - brezi i ndarë për transmetime radiodifuzive sipas Tabelës Nacionale për Shpërndarjen e Frekuencave;”

Amendamenti 20

Neni 3, paragrafi 1.18, pikat:

1.18.1 dhe 1.18.2 fshihen në tërësi.

Amendamenti 21

Neni 3, paragrafi 1.19, ndryshohet si në vijim:

1.19.“ **Subjekti transmetues privat** - çdo shërbim medial privat audio ose audiovizuel, i licencuar nga KPM;”.

Amendamenti 22

Neni 3, paragrafi 1.28, pas fjalëve “veprave audiovizuele”, fshihet “02” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 23

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.31 pika 2, referenca për nënparagrafin “1.30.6”, zëvendësohet me referencën “1.31.6” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 24

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.31 pika 5, referencat për nënparagrafët “1.29.2 dhe 1.29.3”, zëvendësohen me referencat “1.31.2 dhe 1.31.3” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 25

Neni 3, paragrafi 1. nënparagrafi 1.31 pika 6, referencat për nënparagrafët “1.30.1 dhe 1.30.2”, zëvendësohen me referencat “1.31.1 dhe 1.31.2” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 26

Neni 3, pas paragrafit **1.36**, shtohet paragraf i ri **1.37** me tekstin si në vijim:

1.37. “**Radio Transmetimi** - shërbimi medial audio i ofruar nga ofruesi i shërbimit medial për dëgjimin e njëkohshëm të programeve në bazë të një orari të programit;”.

Amendamenti 27

Neni 3, pas paragrafit **1.36**, shtohet paragraf i ri **1.38** me tekstin si në vijim:

1.38. “**Shërbimi medial audio (radio) sipas kërkesës** - (përkatësisht shërbimet e mediave jolineare audiovizuele) shërbimi medial audiovizuel që ofrohet nga ofruesi i shërbimit medial për dëgjimin e programeve në kohën e caktuar nga vetë përdoruesi dhe sipas kërkesës individuale, në bazë të katalogut të programeve të zgjedhura nga ofruesi i shërbimit medial;”.

Amendamenti 28

Neni 3, pas paragrafit **1.36**, shtohet paragraf i ri **1.39** me tekstin si në vijim:

1.39. “**Radio reklamimi** - çfarëdo shpallje publike e transmetuar në këmbim të pagesës, shpërblimit të ngjashëm apo për qëllime të vetë promovimit nga një entitet publik ose privat ose person fizik, lidhur me promovimin e shitjes, blerjes apo qiradhënies së një prodhimi apo shërbimi, për të promovuar përdorimin e produkteve dhe shërbimeve, ose për të prodhuar disa efekte të tjera të dëshiruara nga reklamuesi apo nga vet transmetuesi;”.

Amendamenti 29

Neni 3, pas paragrafit **1.36**, shtohet paragraf i ri **1.40** me tekstin si në vijim:

1.40. “**Arkivi: Shërbimi Medial Audiovizuel** i ruajtur nga ana e të licencuarve me statusin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuel, i cili me kërkesë të KPM-së, është i qasshëm me qëllim të monitorimit të pajtueshmërisë së përmbajtjes programore. Kjo arkivë duhet të ketë gjatësinë një muaj transmetimi.”

Amendamenti 30

Neni 4, paragrafi 2.1, fjala “**shkëmbimin**”, zëvendësohet me fjalën “**shpërndarjen**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 31

Neni 4, paragrafi 2.3, në fund të këtij paragrafi shtohet teksti “, **kurse për entitetet që funksionojnë si OJQ duhet vërtetimit zyrtar mbi regjistrimin e tyre pranë ministrisë përkatëse.**”

Amendamenti 32

Neni 4. paragrafi 2.5. fjalët “**përfituesit fundorë**” zëvendësohen me fjalët “**pronarët përfitues**” dhe kështu të jetë në tërë tekstin e P/ligjit.

Amendamenti 33

Nënparagrafët 2.3, 2.4, 2.5 dhe 2.6 të nenit 4, barten tek neni 24.

Amendamenti 34

Neni 4. nënparagrafi 2.8. ndryshohet si në vijim: “**KPM shqyrton dhe miraton çdo ndryshim të pronësisë për të gjithë të licencuarit dhe të regjistruarit sipas përkufizimit në paragrafin 2.2. të këtij neni.**”

Amendamenti 35

Neni 4, pas nënparagrafit **2.10**, shtohet paragraf i ri **2.11**, me tekstin si në vijim:

2.11. KPM obligon operatorët (ofruesit e shërbimit të internetit) të ndërmarrin të gjitha masat teknike për ndërprerjen e platformave, kanaleve, ose përmbajtjeve të dëmshme vendore ose të huaja të cilat cenojnë sigurinë publike dhe rendin kushtetues në Republikën e Kosovës.”

Amendamenti 36

Neni 4, nënparagrafi 2.18. pas fjalës “**shqyrton**” shtohen fjalët “**dhe miraton**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 37

Neni 4, nënparagrafi 2.19. ndryshohen fjalët” dhënien e lejeve dhe të ankesave” me fjalët “dhënien e lejeve dhe shqyrtimin e ankesave”, dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 38

Neni 4, nënparagrafi 2.24. ndryshohet si vijon: “themelon Këshillin e Ankesave që trajton ankesat e palëve në raport me të licencuarit dhe të regjistruarit në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore si dhe harton e miraton rregulloren e funksionimit të këtij këshilli.”

Amendamenti 39

Neni 5, nënparagrafi 1, pika 1.2. fjalët “pjesa e konsiderueshme”, zëvendësohen me numrin “51%” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 40

Neni 5, nënparagrafi 1, pika 1.3. fjalët “një pjesë e konsiderueshme”, zëvendësohen me numrin “51%” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 41

Neni 5, nënparagrafi 1, pika 1.3. fjalët “një pjesë e konsiderueshme”, zëvendësohen me numrin “51%” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 42

Neni 5, paragrafi 2. ndryshohet si vijon: “Ofruesit e shërbimeve mediale duhet të paraqesin ndryshimet e planifikuara që mund të ndikojnë në përcaktimin e juridiksionit të tyre sipas nënparagrafëve 1.1 dhe 1.2 të këtij neni në KPM dhe brenda 15 ditëve KPM miraton ose refuzon ndryshimet e paraqitura”.

Amendamenti 43

Neni 6, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim: “KPM ka për detyrë të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuele dhe operatorëve të tjerë të cilët shpërndajnë ofrues të shërbimeve mediale, si dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare”.

Amendamenti 44

Neni 6, paragrafi 3, ndryshohet si në vijim: “**KPM përmes procesit të rregullimit kontribuon në profesionalizimin e shërbimeve mediale audiovizuale.**”

Amendamenti 45

Neni 6, paragrafi 4, ndryshohet si në vijim: “KPM-ja mbështet lirinë dhe pluralizmin medial.”.

Amendamenti 46

Neni 9, paragrafi 1, pas fjalës “lejet”, shtohet fjala “regjistrimet”, dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 47

Neni 9, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim: “**KPM i ofron publikut qasje në dokumentacionin, sipas legjislacionit në fuqi për qasje në dokumentet publike.**”

Amendamenti 48

Pas **nenit 9** të projektligjit, shtohet **nen i ri 10** me titull dhe tekstin si në vijim:

Neni 10 Edukimi medial

1. KPM përgatit materiale tekstuale, animacione, video dhe forma tjera të komunikimit për të promovuar edukimin medial.
2. Obligohet RTK që materialet e edukimit medial t’i transmetojë së paku një herë në javë në kohën prime sipas rekomandimeve të KPM-së me kohëzgjatje nga 3 deri 7 minuta dhe pa pagesë.
3. Obligohen të gjitha kanalet gjeneralistike që të transmetojnë materialet e edukimit medial së paku një herë në muaj me kohëzgjatje nga 3 deri 7 minuta dhe pa pagesë.
4. RTK dhe kanalet tjera gjeneralistike obligohen të shfaqin emisione ose debate në funksion të edukimit medial së paku një herë në tre muaj.

Nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 49

Neni 11, paragrafi 2.4, ndryshohet si vijon: “**siguron krijimin e kushteve për cilësinë teknike të transmetimit në Kosovë;**”

Amendamenti 50

Neni 11, paragrafi 4, ndryshohet si vijon: “KPM siguron që programet të përmbajnë dhe pasqyrojnë barazi mes qytetarëve të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.”

Amendamenti 51

Neni 12, paragrafi 1, fshihen fjalët” për arsye që bien në fushat e rregulluara me këtë ligj”.

Amendamenti 52

Neni 13. paragrafi 6. fjalët “jo shqiptare” zëvendësohen me fjalët “jo shumicë”.

Amendamenti 53

Neni 14, paragrafi 1.1. fjalët “gjashtëdhjetë (60) ditësh”, zëvendësohen me fjalët “nëntëdhjetë (90) ditësh”, vazhdon teksti.

Amendamenti 54

Neni 14, paragrafi 1.3. fjalët “njëzet e një (21) ditësh” zëvendësohen me fjalët “dhjetë (10) ditësh”, vazhdon teksti.

Amendamenti 55

Neni 16, paragrafi 1, fjala “zgjidhen”, zëvendësohet me fjalën” zgjedhen” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 56

Neni 16, pas paragrafit 2, shtohet nënparagrafi 2.1. si në vijim:

2.1. “Paragrafi dy (2) i këtij neni nuk zbatohet në rastin e shkarkimit dhe dorëheqjes të Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së.”

Amendamenti 57

Titulli i nenit 17, ndryshohet si në vijim:

“Shkarkimi i Kryetarit dhe anëtarit të KPM-së”

Amendamenti 58

Neni 17, paragrafi 3, fjalët “Shkarkimi i anëtarëve”, zëvendësohen me fjalët “Shkarkimi i anëtarit”, vazhdon teksti.

Amendamenti 59

Neni 17, paragrafi 3, pika 3.6, fshihet në tërësi.

Amendamenti 60

Neni 17, paragrafi 3, pika 3.8, numri “14”, zëvendësohet me numrin “(15)”.

Amendamenti 61

Neni 18, paragrafi 1, fshihen fjalët “Në mbledhjen e parë” vazhdon teksti.

Amendamenti 62

Neni 25 i projektligjit fshihet në tërësi, ndërsa nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 63

Neni 26, paragrafi 3, fshihet fjala “e transmetimit”.

Amendamenti 64

Neni 26, para nënparagrafit 3.1, shtohet pike e re me tekstin si në vijim:

3.1. “partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individ i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike”, ndërsa nënparagrafi në vazhdim rinumërohet.

Amendamenti 65

Neni 26, paragrafi 4, të fshihet fjala “të transmetimit,”.

Amendamenti 66

Neni 26, paragrafi 6, ndryshohet si vijon:” Zyra Ekzekutive mban një regjistër të lejeve dhe regjistrimeve, ku përfshihen kushtet e pajisjes me leje dhe historiku i tyre. Regjistri i lejeve dhe regjistrimeve dhe historiku i tyre publikohet në webfaqen zyrtare dhe përditësohet brenda pesë (5) ditëve pune nga marrja e vendimit të KPM-së.”

Amendamenti 67

Në titullin e nenit 27, fshihet fjala **“të transmetimit “.**

Amendamenti 68

Neni 27, paragrafi 1, fjala “lejave”, zëvendësohet me fjalën “lejeve”.

Amendamenti 69

Neni 35, paragrafi 1, riformulohet si vijon: “Procesi i vlerësimit të aplikacioneve për leje të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale, operatorve të shpërndarjes dhe platformave të shpërndarjes së videove dhe ripërtrirja e lejeve duhet të jetë i drejtë dhe transparent.”

Amendamenti 70

Neni 35, paragrafi 2, riformulohet si vijon: “Vendimet e KPM-së mbi refuzimin ose mosripërtrirjen e lejes arsyetohen me shkrim dhe u dorëzohen aplikantëve nëpërmjet Zyrës Ekzekutive.”

Amendamenti 71

Neni 35, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri pas pikës 35.3 si në vijim:
35.3 ”KPM-ja nxjerr vendim brenda tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të datës për aplikim ose pranimit të kërkesës për leje.”, ndërsa paragrafët në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 72

Neni 36 i projektligjit ndryshohet si në vijim:

Teksti i nenit 36, bëhet paragrafi 1, me ndryshimet si në vijim: pas fjalës “nga ana”, fshihen fjalët “e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat” zëvendësohet me fjalët “e të licencuarve” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 73

Neni 36, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi i ri 2, me tekstin si në vijim:

36.2. **“KPM ruan të drejtën të mos ripërtërijë lejen nëse për këtë ekzistojnë arsye specifike teknologjike dhe rregullatorë.”**

Amendamenti 74

Neni 38, paragrafi 1, fshihen fjalët “Ofruesit e licencuar të shërbimeve mediale audiovizuale” dhe zëvendësohen me fjalët “Të licencuarit” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 75

Neni 38, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri 5, me tekstin si në vijim:

38.5. “Subjektet që rregullohen nga KPM, janë të obliguara që të ofrojnë brenda afatit të përcaktuar kohor të dhënat e kërkuara nga KPM në baza periodike apo me kërkesë për qëllime të analizës së tregut apo rregullimit në përgjithësi.”

Amendamenti 76

Neni 39.5 riformulohet si vijon:” Të licencuarit nga KPM kanë të drejtë ankese në gjykatën kompetente, lidhur me lejen, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.”

Amendamenti 77

Titulli i KAPITULLIT V, riformulohet si vijon:

PARIMET DHE DISPOZITAT THEMELORE PËR TË LICENCUARIT

Amendamenti 78

Neni 41, paragrafi 1, fjalët “audio dhe r espe audiovizuale”, zëvendësohen me fjalët “audio dhe audiovizuale”.

Amendamenti 79

Neni 41, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri 5 me tekstin si në vijim:

41.5.” KPM harton rregullore për ndalimin e dezinformimit. Rregullorja përfshin standardet e Bashkimit Evropian dhe normat ndërkombëtare kundër dezinformimit. “

Amendamenti 80

Neni 42, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, me tekstin si në vijim:

42.2” Të gjitha kanalet televizive me përmbajtje gjeneralistike, si dhe ato lokale që kanë leje të përdorimit të frekuencës, i nënrenditen rregullit të bartjes së detyrueshme (must carry) nga ana e operatorëve kabllor dhe atyre dixhital të shpërndarjes. Në rast të tejngarkesës me të tilla kanale, KPM ruan të drejtën të vendos rregulla komerciale të qasjes.”

Amendamenti 81

Neni 42, paragrafi 2 i projektligjit, fshihet në tërësi.

Amendamenti 82

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 43** me tekstin si në vijim:

Neni 43

Rregullimi i pronësisë së të licencuarve/regjistruarve

8. Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë dhe/ose aksioneve të njoftojë më shkrim KPM-në.
9. Çdo i licencuar/regjistruar obligohet që për çfarëdo ndryshimi të pronësisë mbi vlerën 10% të aksioneve të merr aprovim paraprak me shkrim nga KPM-ja.
10. Asnjë i licencuar/regjistruar nuk mund të transmetojë më shumë se 30% të vlerës së tregut të përgjithshëm medial të komunikimeve komerciale audiovizuale.
11. Një i licencuar/regjistruar nuk mund të zotërojë me shumë se 10% të aksioneve në një të licencuar/regjistruar tjetër.
12. Pronësia në media është e lejuar vetëm për kompanitë ose organizatat të cilat janë të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
13. Në shërbim të pluralizmit medial dhe për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, pronarët përfitues duhet të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për preardhjen e pasurisë me rastin e rigjistrimit dhe raportimit financiar vjetor.
14. KPM bazuar në rezultatet dhe nevojat të cilat rezultojnë nga analiza e tregut medial, me akt nënligjor përcakton rregulla specifike për pronësinë, koncentrimin, pluralizmin, diversitetin, dhe transparencën e mediave.

Amendamenti 83

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 44** me tekstin si në vijim:

Neni 44

Analiza e tregut medial

3. KPM bënë analizën e tregut medial në baza vjetore. Analiza e tregut nga KPM bëhet me qëllim të garantimit të konkurrencës së efektshme në fushën e transmetimeve dhe parandalimit të shpërdorimit të fuqisë në treg nga të licencuarit/regjistruarit e KPM-së.
4. KPM përmes një akti të veçantë nënligjor do t'i përcaktojë rregullat dhe standardet përmes të cilave siguron realizimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të analizës së tregut medial.

Amendamenti 84

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 45** me tekstin si në vijim:

Neni 45

Kërkesat lidhur me transparencën e të licencuarve

2. Të licencuarit janë të obliguar t'i bëjnë publike të dhënat në lidhje me emrin dhe detajet e kontaktit të pronarit apo pronarëve të drejtpërdrejtë me aksionet që u mundësojnë atyre të ushtrojnë ndikim në funksionimin dhe vendimmarrjen strategjike të medias, si dhe pronarët përfitues, pronarët indirekt, aksionet indirekte dhe proporcionet e të drejtave të votimit, si dhe;
 - 3.1. Adresa e banimit ose zyrës së regjistruar;
 - 3.2. Emrat e personave me përgjegjësi ekzekutive;
 - 3.3. Emrat e personave të autorizuar që përfaqësojnë kompaninë/organizatën;
 - 3.4. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, nëse ka të tillë;

Amendamenti 85

Pas nenit 42, të projektligjit shtohet **nen i ri 46** me tekstin si në vijim:

Neni 46

Pronësia e huaj

4. Pronësia e huaj lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale të regjistruara ligjërisht në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Rregullat mbi koncentrimin e të licencuarve të KPM-së vlejné edhe për personat fizik ose juridik të huaj.

Nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 86

Neni 47, pas **paragrafit 6** të projektligjit, shtohet **paragraf i ri 7** me tekstin si në vijim:

7. “OSHMA-të dhe OSH-të obligohen të ndërmarrin masat teknike sipas udhëzimeve të KPM-së në rastin e përmbajtjeve me pritshmëri për të dëmtuar zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve.”

Amendamenti 87

Neni 47, pas **paragrafit 6** të projektligjit, shtohet **paragraf i ri 8** me tekstin si në vijim:

8.” Programet e formatit shfaqje reale televizive (reality show ose reality tv) njoftimet e transmetimit të tyre, si dhe programet që tregojné pasqyra të ngjarjeve në ato përmbajtje, shënohen me 18+ dhe mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 24:00 deri në 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjen e shfaqur me mbrojtje teknike (kodim me pin).”

Amendamenti 88

Neni 47, pas **paragrafit 6** të projektligjit, shtohet **paragraf i ri 9** me tekstin si në vijim:

9. “Programet e formatit (pseudorealiteti), mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 22:00 deri në ora 06:00. Ky kufizim nuk zbatohet për përmbajtjet e shfaqura me mbrojtje teknike (kodim me pin).”

Ndërsa paragrafi 7 i projektligjit rinumërohet.

Amendamenti 89

Neni 56, paragrafi 1.2, para numrit “(20.000)” shtohen fjalët” njëzet mijë”.

Amendamenti 90

Neni 56, paragrafi 1.2, pika 7, para numrit “15” shtohet fjala “pesëmbëdhjetë”.

Amendmenti 91

Neni 56, paragrafi 1.2, pika 23, fshihen fjalët “nenit 37 të”.

Amendamenti 92

Neni 57, paragrafi 1.4, pas fjalës “tre”, shtohet numri “3”.

Amendmenti 93

Neni 57, paragrafi 2, fjala “zbatohet menjëherë” zëvendësohet me fjalët “është përfundimtar në procedurë administrative.”

Konstatim: Komisioni votoi raportin me rekomandime dhe e procedoi për komisionet kryesore.

Mbledhja përfundoi në ora: 13:00

Valon Ramadani,
Kryetari i Komisionit
